

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2220 Prot.

Durrës, më 30.09.2025

V E N D I M

Nr. 73, datë 30.09.2025

"PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE NË "PSIKOLOGJI KLINIKE" PRANË FAKULTETIT TË EDUKIMIT, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës PROGRAM I PËRBASHKËT STUDIMI ME UNIVERSITETIN LA SAPIENZA, ROMË, ITALI"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 21.01.2025, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së, vendimin e Senatit Akademik nr.106, datë 29.09.2025, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e tarifës së programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Psikologji Klinike", pranë Fakultetit të Edukimit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, program i përbashkët studimi me Universitetin La Sapienza, Romë, Itali.
2. Tarifa për këtë program studimi do të jetë 1200 lekë/kredit.
3. Programi i studimit do të zhvillohet në gjuhën: **Shqip, Anglisht dhe Italisht.**
4. Kodi i programit të studimit: **P- 72MS - 0313 – SAI.**
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Drejtoria e Administrimit Financiar
 - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

